UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1887/8, datë 17.6.2013

PËR RREGULLAT DHE KRITERET E HOLLËSISHME PËR KUSHTET TEKNIKE, QË DUHET TË PLOTËSOJNË NDËRTESAT E REJA TË INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 23 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZOJNË:

KREU I

1. Dispozita të përgjithshme

a) Rregullat dhe kriteret e hollësishme për kushtet teknike, që duhet të plotësojnë ndërtesat e reja të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale kanë për qëllim përcaktimin e rregullave të përbashkëta, të cilat do të përbëjnë parimet bazë të ndërtimit dhe të menaxhimit të sistemit të burgjeve.

b) Këto rregulla synojnë të rrisin mundësinë për të arritur rezultatet që janë përcaktuar më parë dhe mbështesin vizionin e institucionit, duke përmirësuar dhe siguruar ngritjen e vazhdueshme të cilësisë së jetesës, shëndetit, sigurisë dhe arritjeve, duke mundësuar monitorimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe rikonstruksioneve, me qëllim që çdo institucion të arrijë një vlerësim të drejtë e të qartë për hartimin e planeve vjetore me synim përmirësimin e politikave të investimeve drejt përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së jetesës, kushteve të punës për të gjithë.

KREU II

2. Përshkrimi teknik dhe funksional

Limitimet e hapësirës, ruajtja e perimetrit të jashtëm dhe ndërtesa e sigurisë së jashtme

1. Ndërtesa e sigurisë së jashtme konsiston në 3 pjesë:

a) Pjesa afër murit kryesor (distanca nga muri kryesor 5 m);

b) Muri kryesor i ndërtuar me përforcime betoni me hekur (i pakalueshëm në mënyrë direkte, me lartësi 5 - 6 m) dhe me një ulluk kalues mbi të;

c) Rrjetë prej teli me gjemba e vendosur brenda një gardhi me lartësi 4,5 m, e ndërtuar në një distancë sigurie. Kush tenton të afrohet te muri i jashtëm ose te gardhi rrethues mund të diktohet në kohë, kështu që nëse do të ketë një penetrim ose tentativë, mund të ndalohet që në pikën e hyrjes.

2. Gardhi duhet të ndërtohet me kthesa të vogla, që të mundësohet shikimi i sektorëve të ndryshëm dhe të jetë i kontrollueshëm me vendosjen e detektorëve të lëvizjes. Korridori ndërmjet murit dhe gardhit duhet të jetë i kalueshëm (në një hapësirë më të vogël të mundshme), sa për të arritur pjesën me çakull, për qëllime mirëmbajtjeje.

3. Projekti i ndërtimit në përgjithësi

a) Projekti i ndërtimit duhet të ketë një ndarje të qartë të hapësirave të ndryshme funksionale (zona e portës, zona administrative, zona e burgimit, zona e punës, zona e vizitorëve, zona teknike). Një ndarje e qartë e hapësirave të ndryshme funksionale duhet të merret, gjithashtu, parasysh për arsye të brendshme: sigurie dhe teknike. Ndërtesat ose pjesët e ndërtesave duhet të strukturohen dhe projektohen qartë në mënyrë që të shmangen pjesët ku mund të fshihesh, cepat e vdekur dhe mundësitë e tjera të fshehjes.

b) Për ndërtimin e murit të jashtëm rrethues të përdoret shtresë betoni, të përforcuar me skarë

hekuri.

c) Fasadat duhet të krijohen duke përdorur material të rrëshqitshëm, në mënyrë që muret të mos jenë të ngjitshme.

ç) Çatia duhet të jetë e veshur me një ekstra shtresë betoni të përforcuar me hekur që të mos thyhet. Kjo vlen për të gjitha çatitë e ndërtesave të tjera.

d) Pozicioni i vendosjes së qelive, kryesisht në zonën e paraburgimit, duhet të jetë i tillë që të shmanget shikimi drejtpërdrejt nga dritaret e qelive, i dhomave të punës dhe i ndërtesave fqinje, sepse nuk lejohet kontakti i të burgosurve me njëri-tjetrin ose me persona të tjerë që janë jashtë burgut, qoftë dhe vizualisht.

dh) Dritaret dhe zonat e ajrimit duhet të pozicionohen në një mënyrë të tillë që të evitohen tentativat e të dënuarve për t'u ngjitur në fasadat e objekteve. Të gjitha pjesët e fasadave (veçanërisht konduktorët e dritave (baxhot e daljes në çati) duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos shërbejnë si ndihmesë për dalje. Kanalet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të mos shërbejnë si një rrugë arratisjeje. Të gjithë kapakët e tyre duhet të pajisen me vida sigurie ose ndonjë bllokim të çdo lloji tjetër. Sidomos kanalet e ventilimit që të çojnë për në fasadën e jashtme duhet të mos jenë të përshtatshme për kontrabandimin e sendeve të ndryshme.

e) Projekti duhet të parashikojë një konceptim (katalog) të ngjyrave që mund të përdoren për lyerjet e ambienteve të brendshme, fasadave, si dhe mobilimin e tyre.

ë) Pjesët e rrugëve ku kalohet me makinë të shtrohen me asfalt që nuk ndizet dhe digjet nga zjarri.

f) Pjesët e dyshemesë që fshihen ose pastrohen shpesh (zyrat, korridoret, ambientet e vizitorëve etj.) duhet të shtrohen me pllaka grez-porcelanat.

g) Në zona të veçanta, si dhoma e mbeturinave, dyshemeja duhet të shtrohet me beton (asfalt) të lëmuar dhe rrethohet me konstruksion metalik me lartësi 2.5 m.

gj) Duhet të instalohen të gjitha rrugët e mundshme të daljes në rast rreziku, duke përfshirë edhe rrugët për te dhomat anësore. Shigjetat treguese dhe drejtuese të lëvizjes, si edhe tabelat e nevojshme orientuese të vendosen në të gjitha katet e ndërtesave.

h) Si masa për mbrojtjen nga zjarri mund të merren:

a) Pjesa e lajmërimit të zjarrit.

b) Një linjë fikse e thatë me hidrantë muri (sipas marrëveshjes me zjarrfikësit) për gradët korresponduese të zjarrit.

c) Izolimi në zonën e instalimit (të ndarat e instaluara për në tavane false duhet të ekzekutohen në koordinim me autoritetin e ndërtimit, si edhe vendosja e fikësave të ndryshëm të fasadës sipas rregullores së autoritetit të ndërtimit).

i) Për standardet që duhet të plotësojnë sistemet e dedektimit të zjarrit dhe sistemi hidrant në institucionet e IEVP:

a) Të vendoset standardi i vitit të fundit i Bashkimit Europian për këto sisteme, si dhe ligjet shqiptare në fuqi.

b) Sistemi i dedektimit të zjarrit të jetë digjital i adresueshëm, digjitale EN 54 dhe monitorimi i tij të bëhet nga operatorët në sallën e monitorimit.

c) Të gjitha godinat në ambientet e brendshme të pajisen me kaseta hidranti për mbrojtjen nga zjarri. Për sistemin hidrant të sigurohet për momentin standardi EN.

d) Godinat të jenë të pajisura me rrufepritëse.

4. Zona funksionale

Ndarja e ambienteve, emërtimi dhe vlerësimi i hapësirave që zë secili prej tyre janë paraqitur në shtojcën nr. 1.

a) Zona e hyrjes nga porta të jashtme duhet të jetë e sigurt dhe e kontrolluar plotësisht nga dhoma e rojeve. Porta të ndahet në dy pjesë, një pjesë për hyrjen dhe daljen e njerëzve (vetëm të një personi) dhe një pjesë për hyrjen ose daljen e makinave. Ato të jenë të ndara nga njëra-tjetra dhe të kontrollohet në mënyrë optimale nga dhoma e rojeve. Hyrja duhet të projektohet në mënyrë të tillë që askush të mos ketë mundësi të afrohen me makinë drejt portës kryesore pa bërë një hark të madh.

b) Pas hyrjes kryesore arrihet në oborrin e brendshëm. Zona e hyrjes komandohet nga dhoma e

rojeve dhe është zona që të drejton për në zonën e mbyllur të institucionit. Personat dhe makinat që hyjnë e dalin nga kjo portë janë të ndarë nëpër korsi dhe nuk mund të qarkullojnë të gjithë bashkë. Madhësia e zonës së rojeve varet nga madhësia e institucionit dhe niveli i tij i sigurisë. Kjo zonë duhet të vendoset si një njësi strukturore e pavarur nga ndërtesat e tjera ose si pjesë e tyre. Vendrojat dhe pjesët e tjera të ndërtesës, ku do të vendosen rojet, duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të ofrojnë të paktën minimumin e sigurisë që ofrojnë ndërtesat e tjera.

c) Zyra e rojeve të portës duhet të pozicionohet e tillë që, dritaret, pjesa e parme e zyrës, pjesa e jashtme e murit rrethues dhe pjesa e brendshme e paraburgimit të mund të shikohen nga jashtë portës nga roja i portës. Shikimi duhet të përmirësohet nga pajisjet elektronike, si: kamera dhe monitorë. Dritaret e zyrës së rojës duhet të jenë të pajisura me veshje antiplumb (C3SF) dhe nëse kërkohet, të jetë e mbyllur me skara hekuri si shtesë. Duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të mos pengojnë ndriçimin, por dhe të eliminojnë reflektimin, i cili mund të krijojë efekt pasqyrë gjatë ditëve me shumë diell. Oficeri i rojës duhet të ketë mundësi të flasë para pranimit dhe të jetë në gjendje të kontrollojë kartat e identitetit, si edhe dokumentacionin tjetër të personave. Zona e zyrës së rojës duhet të ketë madhësi të tillë që të lejojë vendosjen e monitorëve për të operuar lehtësisht nëpër të dhe për në zonën tjetër. Hyrja duhet të orientohet (krijohet), në mënyrë të tillë që lëvizja të drejtohet drejt detektorëve të metalit. Hapësira e kalimit të makinave duhet të ndërtohet sipas madhësisë së makinave që parashikohen (pritet) të kalojnë.

ç) Dhoma kryesore e rojeve duhet të ndërtohen në një vend të mbrojtur dhe afër zonës së marrjes në pyetje. Dhomat e grupit të gatshëm duhet të vendosen pranë tyre. Gjithashtu, në të njëjtën zonë vendoset edhe zona e pushimit të rojeve. Dhomat e zhveshjes për stafin duhet të jenë larg vendit të pritjes së vizitorëve dhe jo gjatë rrugës së kalimit të tyre. Fillimi i detyrës dhe lënia e saj duhet të bëhet në këtë zonë, e cila duhet të jetë kollaj e arritshme, si nga zona e marrjes në pyetje, ashtu dhe nga zona administrative. Duhet të parashikohet edhe një ambient vizitash në zonën e dhomës së rojeve, një ndarje ku të futen pakot që vijnë dhe një mundësi magazinimi për këto pako.

5. Zona e burgimit

a) Godina e akomodimit të të burgosurve duhet të ndjekë rrugën dhe detyrat e burgimit, si p.sh.: paraburgimi për burra, paraburgimi për gra, paraburgimi për të mitur respektivisht; burgimi penal, burgimi i lirshëm, të miturit meshkuj, të miturit femra, departament i nënave me fëmijë, zona e personave të sëmurë.

b) Këto njësi duhet të jenë të kontrollueshme mirë dhe të jenë të vendosura sa më larg të jetë e mundur nga lëvizja që mund të jetë dalja në liri.

c) Duhet të krijohet një rrugë hyrje për të burgosurit në formën e një *check*-in me një kalim të shpejtë nëpër të dhe, gjithashtu, një hyrje dhe dalje nga dhomat e burgimit për në zonën e hyrjes.

ç) Për të burgosurit e rinj dhe ata që lirohen duhet të krijohen “rrugë” kalimi të veçanta, ku të krijohen të gjitha kushtet për përshpejtimin e veprimeve.

d) Duhet të parashikohet krijimi i një dhome për ekzaminime mjekësore, e cila të jetë e lidhur me një tualet.

dh) Për të burgosurit e rinj duhet të ketë një departament hyrës, i cili duhet të dimensionohet në mënyrë të tillë që të burgosurit të hyjnë vetëm nga ajo zonë. Formalitetet e hyrjes janë të izoluara nga veprimet e tjera të regjimit.

6. Seksionet e burgimit

a) Në ambientet e banimit të gjitha muret e sektorëve të burgimit duhet të ndërtohen me hekur/beton.

b) Çdo dhomë burgimi duhet të konsiderohet si zonë e veçantë zjarri.

c) Disa dhoma burgimi (qeli) të lidhura me korridor do të quhen “seksione” dhe do të konsiderohen si një zonë e veçantë.

ç) Godinat e burgimit duhet të ndërtohen, në mënyrë të tillë që të jenë të ndara nga pjesa e jashtme me një distancë të paktën 10 m nga gardhi i sigurisë dhe të menaxhohen në mënyrë të tillë që të mos kenë kontakt me botën e jashtme. Duhet të krijohen si njësi funksionale me sektorët korrespondues. Duhet të merren parasysh edhe rrugët e daljes nga zjarri.

d) Nuk duhet që të paraburgosurit të lejohen të komunikojnë me njëri-tjetrin ose me seksionet që

janë larg njëri-tjetrit. Femrat, gjithashtu, duhet të jenë në një seksion më vete dhe në largësi nga ai i burrave. Seksionet e minorenëve duhet të jenë të ndara nga seksionet e të rriturve.

dh) Korridoret duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për lëvizjen drejt ambienteve të tjera. Gjerësia e tyre duhet të jetë jo më pak se 2.6 m.

e) Tualetet do të jenë të instaluara me dushe. Seksionet mund të parashikohen me bllok dushesh deri në katër bokse.

ë) Dritaret nga ana e veriut duhet të evitohen. Hapësira drite e dritareve nuk duhet të jetë më pak se 160x150 cm.

f) Materiali për prodhimin e dritareve duhet të jetë prodhim i Komunitetit Europian. Elementet e dritares duhet të jenë të paçmontueshme. Xhamat e dritares të jenë antivandal. Ngjyra të përcaktohet në harmoni me koloret e fasadës.

g) Dyert e qelive të burgimit të jenë prej çeliku, me çelësa specialë sigurie dhe me sportel të vogël me xham antivandal me përmasa 22x26 cm.

gj) Skarat metalike të dritareve dhe dyerve të jenë me hekur çelik (jo ndërtimi) me diametër jo më të vogël se Ø 22 mm, kombinuar me shirita metalikë me profil jo më të vogël se 12x12 mm.

h) Në sektor duhet do të instalohet sistemi i vëzhgimit me kamera.

Brenda çdo sektori do të jenë, si pjesë e pandarë, dhomat rekreative, magazinë për seksionin, magazina e të dënuarve dhe kuzhina private.

i) Të gjitha katet e godinës ku mbahen të dënuarit duhet të përshkohen nga ashensori. Përmasat e ashensorit do të jenë të tilla që të mbajnë barelën e të sëmurëve ose të lëvizë me kapacitet deri në 8 (tetë) persona.

j) Të gjitha hapjet që lidhen me jashtë, si: dritare, dyer etj., duhet të sigurohen me skara hekuri.

7. Qelitë e burgimit

a) Çdo qeli burgimi duhet të pajiset me një tualet që të jetë i ndarë nga pjesa e banimit. Çdo qeli burgimi duhet të mobilohet me krevat, një karrige, një kuti të vogël mobilierie për rrobat, një kuti të vogël për sende të tjera, një tavolinë të vogël për të shkruar, një vend për tavolinë të përbashkët edhe një vend për frigorifer, radion ose TV. Mobiliet duhet të jenë të vendosura dhe të ndërtuara në mënyrë të tillë që të mos krijojnë mundësi fshehje dhe të krijojnë mundësi kontrolli të mira për rojet. Duhet të sigurohet mundësia për të ndryshuar mobilimin pa ndonjë vështirësi të madhe.

b) Duhet të krijohen rrjeti i duhur i prizave dhe i spinave. Ndriçuesit nëpër qeli të jenë pllafonierë inkandeshentë, antivandalë.

c) Shtresa e dyshemesë duhet të jetë rezistente nga dëmtimet dhe fërkimi (shtresë rezistente sintetike).

ç) Hyrja në qeli të sigurohet dhe garantohet me derë të blinduar me skarë hekuri, e cila të hapet nga jashtë. Dyert e qelive të burgimit duhet të jenë prej çeliku dhe me çelësa specialë sigurie. Dyert duhet të pajisen me një hapje të vogël prej xhami dhe një hapje tjetër ku të kalojë ushqimi me përmasa 22×26 cm. Skara e derës së qelisë duhet të jetë me krahë hapje të njëjtë me derën e blinduar.

d) Dera e tualetit duhet të vendoset në pozicion të tillë që të mos pengojë pamjen e brendshme të qelisë kur të kontrollohet nga jashtë ose nga dritarja e derës. Të gjithë sektorët dhe katet duhet të jenë të pajisura me bokse dushi me dyer të lëkundshme (vaj-vija) me 1 m trup, kështu që të burgosurit që nuk e ndjejnë veten të ekspozuar ndaj të burgosurve të tjerë mund (jo të mos) t'i përdorin dushet e përbashkëta.

8. Qelitë e ndara të burgimit

a) Një numër i mjaftueshëm qelish duhet të krijohet si qeli të veçanta burgimi (qeli izolimi me minimumin e pajisjeve), si edhe qeli veçanërisht të mbrojtura nga burgimi. Në këto qeli nuk duhet të vendosen kaloriferë, por duhet të ngrohen nëpërmjet sistemit qendror të ngrohjes me tubacione që kalojnë nëpër mure ose nën dysheme, ose me fryrje nga korridori, nëpërmjet grilave të fryrjes.

b) Për të parandaluar plagosjet, muret duhet të jenë me sipërfaqe të lëmuara. Mobiliet duhet të jenë të fiksuara në mure ose me tokën. Pajisjet sanitare të jenë shumë të sigurta dhe të inkastruara mirë. Këto qeli të veçanta duhet të jenë të integruara nëpër seksione.

9. Zyrat e shërbimit të seksioneve

Zyrat e seksionit duhet të jenë të vendosura nëpër sektorë dhe në pozicion të tillë që të arrijnë të

kenë një shikim të përgjithshëm në të gjithë seksionin. Në to duhet të integrohen pajisjet teknike të sigurisë. Zyrat duhet të pajisen me njësi sanitare, hapësira për çaj dhe hapësira të vogla pushimi.

10. Hapësirat për çaj (zona e burgimit/zona e interrogimit/dhomat e përbashkëta)

Seksionet individuale duhet të kenë një vend gatimi e çaji. Ato duhet të jenë të përshtatshme për përgatitjen e ushqimeve të thjeshta (të këtë frigorifer, mundësi gatimi, mikrovalë, makinë kafeje etj.). Në zonën e këtyre hapësirave të gatimit duhet të ketë një vend të mjaftueshëm për t'u ulur dhe për ngrënie. Duhet pasur kujdes që zgjedhja e veshjes së dyshemesë, të bëhet sipas kërkesave të dhomës.

11. Dhomat anësore në zonat e burgimit

Një dhomë e vogël magazinimi dhe një dhomë për mbeturinat, e ajrosur duhet të krijohen si shtesë në zonat e burgimit dhe, gjithashtu, edhe një dhomë për lavatriçet.

12. Dyqan ushqimesh shtesë

a) Duhet të parashikohet sistemimi i një dyqani ushqimesh shtesë për mallra ushqimore dhe gjysmë luksi.

b) Të krijohen mundësi për lëvizje të lirë të furnizuesit. Duhet të krijohen kapacitete të mjaftueshme për dyqanin dhe magazinën e tij.

c) Duhet të krijohen rrugë kalimi të veçanta për shfrytëzimin e këtij dyqani nga të burgosurit e niveleve të ndryshme të sigurisë.

13. Shërbimi mjekësor

a) Ky shërbim duhet të vendoset në qendër të objektit, në mënyrë që të arrihet sa më shpejt nga të gjitha seksionet e burgimit. Shërbimi shëndetësor duhet të ketë ambiente, standarde dhe mjete sipas shtojcës 2.

b) Gjerësia e dhomave dhe e korridoreve te sektori i mjekut të jenë minimumi të paktën 2.20 m për transportimin e krevateve (barelave) të urgjencës. Dyert e këtyre dhomave të jenë të pajisura dhe në përmasa sa dyert e dhomave të të ndaluarve. Një tualet i përshtatshëm me aksesorë për persona të sëmurë të paralizuar duhet të krijohet të paktën në dy dhoma.

14. Palestra (dhoma e gjimnastikës me madhësi standarde) dhe dhomat e ushtrimeve fizike

a) Këto ambiente duhet të vendosen në një zonë të mbyllur sa më në qendër të jetë e mundur. Dhoma e gjimnastikës duhet të jetë e përshtatshme për lojëra me top, konstruksioni i dyshemesë duhet të jetë elastik, muret duhet të jenë të forta. Dhoma e ushtrimeve fizike duhet të krijohet me një dysheme, e cila të mundësojë instalimin e pajisjeve të ndryshme sportive.

b) Duhet të ketë tualetet e veta dhe një dhomë për vendosjen e pajisjeve sportive. Dhoma e gjimnastikës duhet të ketë edhe një hyrje shtesë dhe një dalje.

15. Dhoma multifunksionale

a) Kjo dhomë duhet të krijohet në një zonë të mbyllur sa më në qendër të jetë e mundur. Dhoma multifunksionale duhet të formohet në mënyrë që të ndahet dhe të jetë e përdorshme për evenimente dhe shërbime të ndryshme.

b) Këto dhoma duhet të ndërtohen që të shërbejnë si ambiente kulti, sallë për televizorë e mbledhje edhe si dhoma falje për ritet fetare.

16. Zona e vizitorëve

a) Pozicioni i zonës së vizitorëve duhet të zgjidhet i tillë që rrugët e kalimit të vizitorëve duhet të jenë detyrimisht të ndara nga rrugët e kalimit të të burgosurve në qeli. Zona e vizitorëve duhet të jetë në afërsi me hyrje-daljen e paraburgimit dhe lëvizja e të dënuarve duhet të bëhet në rrugë sa më të shkurtra për në qeli. Hyrjet duhet të ruhen respektivisht me detektorë metali.

b) Ndarja ndërmjet vizitorëve dhe të burgosurve në zonën e vizitave kryhet me anë të një xhami. Aparatet telefonike vendosen në të dyja anët. Duhet të kihet kujdes për masat që merren gjatë bisedave të të burgosurve.

17. Zonat e punës (punishtja, kuzhina etj.)

a) Të burgosurit duhet të punojnë, duke qenë se puna është okupim terapik dhe edukim profesional (duke përfshirë edhe grupet e mësimit). Zona e punës dhe e jetesës, duhet të jenë të ndara dhe nëse është e mundur në ndërtesa të veçanta.

b) Ambientet e punës duhet të organizohen si për meshkuj edhe për femra duke pasur parasysh

edhe kërkesat e ligjit për mbrojtjen e punëtorëve në punë.

c) Në ambiente duhet të ketë priza dhe spina të mjaftueshme dhe dyshemeja duhet të jetë e një cilësie industriale.

ç) Të burgosurit duhet të kenë një dhomë zhveshjeje dhe mundësi për të bërë dush.

d) Hyrja e punishtes duhet të jetë e skanuar dhe nëse është e nevojshme të kontrollohet me detektorë metali.

dh) Duhet të ketë vende parkimi jashtë punishtes për makinat e punës.

e) Duhet të ketë një dhomë magazinimi për veglat.

ë) Në zonën e kuzhinës duhet të ketë një hapësirë ku të burgosurit të pushojnë gjatë punës, si mensë e vogël.

18. Zona e ekzaminimit, dhomat e konsultës

a) Vendosja e dhomave të ekzaminimit dhe të konsultës duhet të jetë e tillë që rruga e kalimit të të burgosurve duhet të jetë e ndarë nga rruga e të kalimit të të burgosurve për në qelitë e tyre.

b) Dhoma e ekzaminimit përfaqëson pjesën komunikuese me oborrin, prandaj duhet të vendoset sa më afër në mënyrë që të arrihet pa vështirësi nga oborri. Këtej do të nxirren të burgosurit për në oborr e më tej.

c) Duhet të ketë një dhomë të vogël pritjeje ku të qëndrojë i burgosuri, ndërkohë që punonjësi i policisë kryen veprimet. Gjatë pritjes, i burgosuri duhet të jetë i mbyllur në këtë dhomë për të kaluar më pas te zona e interrogimit.

ç) Dhomat e konsultës duhet të pajisen me EDP.

19. Aksi lidhës ndërmjet oborrit dhe qendrës së paraburgimit

a) Duhet të ekzistojë vetëm një aks lidhjeje sa më i shkurtër ndërmjet oborrit dhe paraburgimit. Zona e mbërritjes duhet të krijohet në aksin e kësaj lidhjeje.

b) Duhet të bëhet i pamundur shikimi jashtë nga ky aks. Aksi lidhës duhet të krijohet si lidhje sigurie me kontrolle nga të dyja daljet për në oborr dhe në qendrën e paraburgimit.

20. Ambiente në oborr

a) Në këto ambiente kryhen aktivitete dhe ajrim në periudhë të ftohtë dimri ose në ditë të nxehta. Këto ambiente duhet të jenë me konstruksione metalike të lehtësuara.

b) Ato duhet të pajisen me tualet, të cilat të jenë të kontrollueshme nga punonjësit e sigurisë.

21. Zona administrative

a) Ajo duhet të vendoset pranë zonës së ardhjes. Sistemimet duhet të bëhen duke marrë parasysh mbrojtjen e punonjësve.

b) Hapësirat e zyrave janë standarde, duke pasur parasysh numrin e punonjësve dhe llojin e aktivitetit të punës.

22. Kuzhina dhe dhoma e ngrënies për stafin

a) Kuzhina duhet të vendoset në zonën e administratës dhe të jetë e paarritshme për vizitorët. Kuzhina për stafin duhet të jetë si versioni i kuzhinës për ushqimin e përgatitur në kuzhinën e institucionit.

b) Duhet të ketë vend të mjaftueshëm për transportin e ushqimeve. Dhoma e ngrënies për stafin do të shërbejë në të njëjtën kohë edhe si ambient social.

23. Zona e furnizimit dhe zonat ekonomike

Zona e furnizimit dhe zona ekonomike duhet të arrihen në mënyrë të veçantë nga hyrja kryesore. Hapësirat e sheshit dhe të rrugëve duhet të jenë të tilla që të marrin parasysh mundësinë për të marrë kthesën kamionët-autobusët. Sipërfaqja e tyre të jetë e shtruar me asfalt.

24. Zonat e jashtme të shëtitjes/zonat e lira

a) Zonat e jashtme të shëtitjes duhet të jenë sa më afër qelive të të burgosurve. Këto zona duhet të kenë formë të tillë, që të jenë sa më të shkueshme dhe të kontrollueshme nga vendet e rojeve.

b) Zonat sportive nuk është e nevojshme të jenë me përmasa olimpike, por të jenë funksionale e lehtësisht të kontrollueshme. Duhet të krijohen mundësi të mjaftueshme për të burgosurit që të qëndrojnë në hapësira të hapura.

KREU III
VLERAT E IDENTIFIKIMIT FIZIK

25. Vlerat e identifikimit fizik

Këtu jepen vlerat e identifikimit fizik, të vlefshme në shumicën e standardeve europiane me komponentë të rëndësishëm, sipas shtojcës 3.

26. Mbrojtja termike

Meqenëse skema e kësaj ndërtese është e ngjashme me një ndërtesë të banueshme, vlerat U ndërtuese janë të vlefshme sipas standardeve të përmendura më sipër me gjithë specifikimet konstruktive.

27. Konstruksioni i dritareve dhe i xhamave

Për ambientet e ngrohura, duhet të merret parasysh që maksimumi i vlerave U për konstruksionet e keadreve të dritareve dhe dyerve të jetë 1.90 W/m^2K. Me zhvillimin teknologjisë së ditëve të sotme, një keadër dritareje U duhet të jetë =<1.30-1.40 W/m^2, duke përfshirë rrugën komplete të koeficientit të ngrohtësisë për dritaret.

28. Përmbledhje e proteksionit termik

a) Në princip mund të thuhet që veshjet me xhama vertikalë dhe horizontalë, të cilat janë të ekspozuara ndaj diellit, duhet të kombinohen me një mbrojtje të jashtme ndaj diellit.

b) Reduktimi më i mirë struktural kundër mbingrohjes është me anë të një mbrojtjeje të jashtme e fleksibël kundër diellit. Një mbrojtje e cilësisë së lartë kundër rrezatimit të diellit është e mundur në qendrën e paraburgimit. (=<0.35=[-]).

29. Veshja strukturale kundër zhurmës/akustikës

Veshja kundër zhurmës e qelive individuale planifikohet sipas kërkesave të standardeve.

30. Muret e jashtme/çatitë/zonat me xham/dritaret

Për përmbushjen e kërkesave në vlera minimale për absorbimin e zhurmave të komponentëve të jashtëm dhe për zgjatjen ekuivalente të reduktimit të saj, duhet të përdoren materiale, të cilat njihen dhe realizojnë më së miri eliminimin e zhurmave dhe temperaturave.

31. Muret e brendshme

Në princip, duhet të ketë një diferencë të standardit të zhurmës Dn, ndërmjet dhomave të ditës për zhvillimin e punëve të ndryshme, me rreth 55 dB pa hapje (50 dB me hapje) dhe për dhomat në një ambient pune, për Dn për T for WT <W< = 44 dB, siç është pa hapje (35 dB me hapje).

32. Konstruksionet e shtresave

Maksimumi i standardizuar i zhurmës së goditjes mund të arrihet duke bërë një veshje të rrjedhshme me konstruksione shtresash të rënda.

33. Gjykimi mbi inxhinierinë e zërit për agregatet teknologjike

Të gjitha teknologjitë e brendshme duhet të ndërtohen ose të atashohen me pajisje për uljen e zhurmës.

34. Akustika

Vlerësimi i pajisjeve të akustikës duhet të jetë sipas standardeve të fundit europiane. Kur merren masat akustike për ambientet ku dëshirohet të ketë një dëgjim të mirë, duhet të krijohet një diferencë ndërmjet këtyre ambienteve (për seminare, multifunksionale etj.) dhe ambienteve në të cilat zhurma mund të eliminohet deri në një nivel të caktuar, si p.sh. dhomat e pritjes.

35. Zyrat, dhoma qendrore e rojeve

a) Në këtë ambient nëpërmjet veshjes me shtresa të pjesshme do të arrihet maksimumi i lejueshëm i kohës së rikthimit të zërit.

b) Objektet e sallës (mobilet, perdet) mundet, gjithashtu, të jenë efektive në reduktimin e zhurmës dhe përmirësimin e nivelit të akustikës.

36. Zona e vizitorëve, zona e marrjes në pyetje

Veshja me shtresa e këtyre ambienteve duhet të bëhet e tillë që rikthimi i zërit dhe niveli i reduktimit të zhurmës të arrijnë maksimumin e lejueshëm.

37. Korridori hyrës, pikat e vëzhgimit dhe të lëvizjes

Në zonat e lëvizjes mund të jetë një shtresë më pak ose të përdoren panelet me karton, në mënyrë

që të arrihet mjaftueshëm ulja e nivelit të zhurmës. Gjithashtu, mund të krijohen zonat e nevojshme për absorbimin e zhurmës. (Koha e llogaritur nuk duhet t'i kalojë të 1.5 sekondat.)

38. Dhomat e burgimit

Duhet të planifikohet ulja e nivelit të zhurmës në sektorët e burgimit, veçanërisht në dhomat e përbashkëta të kohës së lirë dhe në ambientet e lëvizjes. Masat akustike duhet të merren duke veshur muret me shtresat e nevojshme që shërbejnë për këtë qëllim.

39. Dhoma e ngrënies dhe e ndenjes

Dhoma e ngrënies dhe e ndenjes duhet të përfshihen, gjithashtu, në masat akustike për uljen e nivelit të zhurmës. Këto ambiente duhet të jenë prioritete, për të bërë veshjen me shtresa nëpër mure.

40. Sistemi i shkollimit, klasat, salla multifunksionale

Koha e kthimit të zërit në klasa duhet të jetë 0.7 sipas frekuencës së mesme prej 500 Hz 0.9 sek. Duhet të vihet, pra një shtresë akustike e pjesshme si rregull.

41. Dhoma e gjimnastikës dhe e sporteve

Dhomat e sporteve duhet, gjithashtu, të përfshijnë masa akustike për reduktimin e nivelit të zhurmës. Kjo realizohet nëpërmjet veshjes së mureve me shtresa.

KREU IV
PAJISJET TEKNIKE DHE ELEKTRIKE

42. Pajisjet teknike dhe elektrike duhet të plotësojnë parametrat e duhur cilësorë dhe kërkesat e sigurisë që janë të rëndësishme për një qendër paraburgimi.

43. Ushqimi i rrjetit

a) Ushqimi i objektit me energji elektrike duhet të bëhet me anë të një rrjeti kryesor që nënkupton një linjë furnizimi 20 KW dhe një burimi dytësor.

b) Duhet të planifikohet edhe sigurimi i një transformatori (mundësisht i montuar në kabinë) dhe gjeneratori rezervë, në mënyrë që të evitohet ndërprerja e energjisë elektrike.

44. Furnizimi me energji në raste emergjence

a) Në rastin e mungesës së energjisë elektrike nga linja kryesore duhet të planifikohet të vendoset gjeneratori i emergjencës, për mbajtjen në punë të pajisjeve më të nevojshme në objekt dhe të merret parasysh një rezervë prej 50%.

b) Të gjitha pajisjet për sigurinë duhet të jenë të lidhura me furnizimin e emergjencës. Këto janë veçanërisht:

i) sistemi i ngrohjes;

ii) sistemi i presionit;

iii) sistemi i përpunimit të mbeturinave dhe atyre sanitare;

iv) ç) ashensorët me kontroll zjarri;

v) barrierat që hapen e mbyllen me energji elektrike, portat;

vi) dh) komplet ndriçimi i brendshëm;

vii) komplet ndriçimi i jashtëm;

viii) ekzaminimi i alarmit për sigurinë e jashtme.

45. Furnizimi me energji të pandërprerë

Për furnizimin e pajisjeve teknologjike të sigurisë duhet të planifikohet furnizimi me energji të pandërprerë. Kjo duhet veçanërisht për serverët, për pajisjet e alarmit dhe të videokamerave, sistemet e hyrjes dhe të daljes etj.

47. Dizenjoja e përgjithshme e instalimit

a) Instalimet që do të kryhen në objekt duhen të bëhet në mënyrë fine, me futje në beton në mënyrë që të mos lejohen manipulimet.

b) Për të siguruar lehtësi në përdorimin dhe menaxhimin e mëvonshëm të këtyre sistemeve duhet të shënohen, të lihet gjurmë në rrugët e shtrimit dhe instalimit, në mënyrë që kjo të mbahet parasysh kur të kryhen punime më vonë ose gjatë riparimit të defekteve.

c) Sistemet e instalimit zakonisht vendosen jashtë mureve, në tavane të varura, nëpër kanelina plastike e metalike.

48. Pajisjet në mure

Pajisjet në muret e dhomave të burgimit janë të lejuara, por ato duhet të jenë të fiksuara mirë teknikisht dhe të sigurta në përdorim.

49. Pajisjet e ndriçimit

Pajisjet e ndriçimit duhet të vendosen sipas standardeve europiane. Sipas përkatësisë, destinacionit të ambientit, duhet të aplikohen vlerat e ndriçimit sipas shtojcës 4.

50. Pajisjet e tokëzimit dhe rrufeve

Në objekte duhet të planifikohet realizimi i rrjetit të tokëzimit dhe mbrojtjes nga rrufetë.

51. Pajisjet e sistemit të alarmit nga zjarri

Objekti duhet të pajiset me një pajisje automatike për të treguar zonën e zjarrit.

52. Instalimi i telefonave

Mund të vendosen lidhjet telefonike të shpejta për hapësirat individuale të zyrave. Një kombinim duhet të vendoset nga terminalet dhe lidhjet e shpejta për te zonat e tjera të lidhjes.

53. Pajisjet e fonisë

Për zonat e lëvizjes në ajër të pastër (sheshet e ajrimit) dhe zona të tjera të përgjithshme mund të vendoset një pajisje fonie me anë të së cilës mund të komunikohet nga çdo zyrë. Gjithashtu, duhet të ketë foni në çdo qeli burgimi.

54. Sistemi i antenave

a) Duhet të planifikohet vendosja e një antene qendrore dhe me anë të saj të dërgohet sinjal në qelitë e burgimit dhe në dhomat sociale.

b) Duhet të vendoset një pajisje satelitore nëpërmjet së cilës të merren edhe stacionet digjitale të radios dhe televizionit në mënyrë qendrore. Në këtë mënyrë do të jepet mundësia që të dëgjohen programet digjitale të radios dhe televizionit nëpër qelitë e burgimit.

55. Lidhjet e strukturuara

Për realizimin e rrjetit të IT-së për postet e punës individuale, kablloja do të jetë “kabllo rrjeti informatik kategoria e 7-të” (UTP ose CTP). Prizat të jenë të dallueshme. Nëpërmjet ngjyrave të përcaktohet priza e fuqisë dhe priza e UP, modul telefoni dhe modul interneti.

KREU V
PAJISJET TEKNOLOGJIKE TË SIGURISË

56. Pajisjet teknologjike të sigurisë duhet të shërbejnë për të parandaluar arratisjen e të burgosurve ose ndalimin e personave që hyjnë në mbështetje të të burgosurve. Ato duhet të garantojnë mbrojtjen e rojeve, duke i siguruar nëpërmjet zbulimit të sulmeve, që mund të ndërmarrin të burgosurit mbi rojet, por edhe midis tyre, sa më shpejt që të jetë e mundur.

57. Muri i sigurisë

E gjithë zona e institucionit duhet të jetë e rrethuar me një mur sigurie me lartësi të konsiderueshme. Muri rrethues të jetë me lartësi deri në 6 m dhe me ulluk me gjerësi 1 m, për lëvizjen e personelit të shërbimit. Në gjatësi të murit të vendosen vendshërbime për punonjësit roje të policisë. Muri duhet të ndriçohet nga të dyja anët. Ndriçuesit të vendosen në mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen dhe shikimin e rojave.

58. Vendshërbimet

a) Vendshërbimet të jenë me lartësi deri në 2.4 – 2.6 m nga dyshemeja e ullukut, me përmasa deri në 140x160 cm, të mbrojtura me vetrata me xham antiplumb. Në mes të fiksohet një stol i rrotullueshëm në 360° me lartësi mbi murrin e ullukut.

b) Në çdo vendshërbim të ketë të instaluar stanok për vendosjen e armës, një prozhektor të rrotullueshëm dhe për nevojat e vogla personale të instalohet pishuar.

59. Gardhi mbrojtës

Brenda zonës duhet të vendoset një gardh i përshtatshëm mbrojtës, paralel me murin e sigurisë.

60. Dyert, hapësirat

Zonat e brendshme duhet të bllokohen me dyer që mbyllen me kyçe të automatizuara.

61. Ndriçimi

Për të mundësuar një mbikëqyrje sa më mirë të zonave të ndryshme brenda dhe jashtë objektit duhet të instalohen pajisje të përshtatshme ndriçimi, të cilat mund të specifikohen si më poshtë:

62. Ndriçim i përgjithshëm

Ndriçimi i përgjithshëm shërben për të kryer aktivitetin e përgjithshëm dhe aktivitetet në zonat e lëvizjes së jashtme ose në zonat e kapanoneve të punës.

63. Ndriçimi mbikëqyrës

Komplet zona ndërmjet murit të sigurisë dhe gardhit mbrojtës duhet të jetë e ndriçuar. Ndriçuesit duhet të jenë të vendosur në lartësinë e duhur dhe me ndriçimin e duhur.

64. Ndriçimi i zonave të oborreve të brendshme

Për ndriçimin e zonave të oborreve të brendshme të vendosen shtylla me disa pika ndriçimi ose zona të ndriçohet nga ndërtesat.

65. Ndriçimi në fasadë

Këto zona ndriçohen me drita të buta për të siguruar supervizimin me kamera të fasadës dhe të ndërtesës së burgimit. Këto drita vendosen në mënyrë të tillë që të sigurohet një qartësi sa më e mirë për kamerat dhe monitorët e videokamerave, njerëzit të mos shqetësohen nga drita e tyre. Pajisjet e ndriçimit dhe ndriçuesit të jenë sa më ekonomikë.

66. Dritat e alarmit

Si shtesë e ndriçimit të zakonshëm dhe ndriçimit të jashtëm të përdoren edhe dritat e alarmit me halogjen për të sinjalizuar lëvizjen dhe lokalizimin e personave.

67. Furnizimi me energji në rast emergjence

Për të mundësuar sigurimin e vazhdueshëm të energjisë, në rast të ndërprerjes së rrjetit kryesor për shkak të një defekti teknik, ndriçimi i jashtëm, i brendshëm dhe dritat e alarmit të furnizohen nga burimi i emergjencës, që janë motogjeneratorët dhe UP.

68. Telefonia e të dënuarve me familjarët

Pajisja duhet të vendoset për 8 poste për vizitorët. Kabllot lidhës duhet të vendosen brenda tubave metalikë. Kontrolli i saj të bëhet nga zyra, ku një operator është përgjegjës për shërbimin dhe kontrollin. Pajisja të jetë antivandal, të ketë cilësi të larta në kryerjen e bisedës dhe të jetë e menaxhueshme.

69. Pajisjet e videos

E gjithë zona e paraburgimit, zonat e brendshme, të jashtme dhe rrethimi do të mbikëqyren me kamera. Kontrolli i tyre kryhet me anë të monitorëve që janë të lidhur me kamerat dhe kryhen nga zyra e rojës (operatorët) ose në sallën e kontrollit. Ndarja e zonave do të bëhet si më poshtë:

70. Zona e jashtme

Kontrolli i lëvizjes në këto zona bëhet nëpërmjet pajisjeve që do të mbulojnë zonën e jashtme, parkimin, zonën e kalimit të dyerve.

71. Zona e paraalarmit

Këtu supervizohen zonat jashtë murit të sigurisë, nëpërmjet një fijëzimi automatik që sinjalizon lëvizjet.

72. Zona e sigurisë së brendshme

Zona e sigurisë së brendshme është muri i sigurisë dhe gardhi mbrojtës deri te muret e ndërtesave. Në këtë zonë supervizohen zonat e jashtme, muri i sigurisë dhe zona te gardhi mbrojtës (bëhet detektimi i lëvizjes me anë të vlerësimit të figurës me videodiferencim).

73. Supervizimi i fasadës

Fasadat e ndërtesës së burgimit supervizohen nga videokamera, të cilat janë të montuara dhe të rregulluara me lëvizje në mënyrë të shpejtë dhe që tregojnë objekte veçanërisht intensive.

KREU VI
NGROHJA, KLIMATIZIMI, VENTILIMI DHE PAJISJET SANITARE

74. E gjithë teknologjia e objektit duhet të ekzekutohet sipas direktivave të duhura, normave dhe edicioneve respektive.

75. Furnizimi me ngrohje

a) Sistemi i ngrohjes së objektit nisur nga ana ekonomike duhet të realizohet me ngrohje qendrore me kaldajë me gaz, me naftë dhe me panele diellore në kombinim dhe me pompa nxehtësie.

b) Gjatë instalimit të rrjetit të ujit të ftohtë dhe atij të pijshëm duhet të mbahet parasysh të vendosen edhe pajisjet e përpunimit të ujit.

76. Sistemi i ngrohjes

Si bazë për instalimin e sistemit të ngrohjes do të shërbejnë pompat me rrymë, elektrodinamikë ose hidrodinamikë. Ndarja e mënyrës së ngrohjes duhet të bëhet sipas përdorimit të ndryshëm të sektorëve, standardeve të ndryshme të temperaturës, drejtimeve nga dielli etj. Pompat ngrohëse janë agregatë dopio.

77. Tubacionet

Tubacionet që shpërndajnë ujin e ngrohtë në linja të ndryshme, linjat shpërndarëse nëpër kate që shkojnë nëpër radiator nga sistemi qendror i tubacioneve; instalimi i rregullatorëve të ndryshëm, të presionit nëpër rrugët e lëvizjes, valvulat e shpërndarjes, nëpër kate që rregullojnë linjat lidhëse, të jenë prodhim i certifikuar i BE-së.

78. Izolimi i tubacioneve

Të bëhet izolimi i plotë i sistemit të tubacioneve, duke rritur në këtë mënyrë fuqinë ngrohëse. Shpërndarja e tubave të izoluar në zona të dukshme, si p.sh. në zyrat qendrore, të bëhet nëpërmjet bodrumit dhe në kate të mbulohet me një veshje alumini.

79. Pajisjet sanitare

a) Gjatë ndërtimit të rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë të ftohtë, të respektohen të gjitha standardet dhe normativat e nevojës për ujë. Nevojat do të plotësohen nëpërmjet depove të ujit të pijshëm me volum 100-150 m^3.

b) Të instalohen matës uji, aparat për filtrim, pajisje për ngritjen e presionit, pajisje zbutëse për ujin që furnizon kuzhinën.

80. Pajisja e ujit të ngrohtë

Uji i ngrohtë përpunohet nëpërmjet një sistemi qendror të ujit. Për objekte të veçanta, si kuzhina, të planifikohet instalimi i një rezervuari inoksi, që duhet të plotësojë disa parametra të veçantë lidhur me pastërtinë dhe higjienën.

81. Objektet sanitare

a) Pajisjet h/sanitare në tualetet e qelive të jenë inoksi për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Tubacionet e ujit për larjen e këtyre pajisjeve të jenë prej çeliku të cilësisë së lartë, të kalojnë në pusin e tubacioneve dhe uji që kalon në të, të ketë presionin e mjaftueshëm, me qëllim për të realizuar shpëlarjen dhe më pas shkarkimin dhe thithjen e ujit nëpërmjet piletës dhe tubacioneve të dyshemesë. Pastrimi i tualetit të realizohet vetëm me anë të një butoni. Pjesa tjetër e mekanizmit të jetë e fshehur në mur.

b) Në qelitë për personat e sëmurë rëndë e të paralizuar të planifikohet instalimi i pajisjeve sanitare të përshtatshme për invalidë.

c) Pllakat e dusheve të jenë me pileta shkarkimi, grupet e aparateve sanitare të jenë me doreza të kromuara, me termostat sigurie (40°C).

ç) Të gjithë aksesorët sanitarë për të gjithë objektin duhet të jenë çelik i cilësisë së lartë (inoks), si p.sh.: mbajtësi i letrës higjienike, gota e furçës së dhëmbëve, koshi i mbeturinave, varësja e peshqirit, mbajtësi i sapunit.

82. Ndihma e parë për shuarjen e zjarrit

Projekti për mbrojtjen nga zjarri duhet të parashikojë instalimin e plotë të rrjetit të mbrojtjes nga zjarri me hidrantë uji brenda dhe jashtë, por dhe pajisjen e objektit me mjete për shuarjen e zjarrit, si fikës zjarri nëpër mure dhe kaseta me mjete të tjera për shuarjen e tij.

83. Ujitja e jashtme

Kryhet me hidrantë në mënyrë qendrore dhe lokale, me hapje e mbyllje automatike dhe me

distancë rreth 25 m.

84. Pajisjet e ventilimit

a) Zakonisht ventilimi është i ndarë nga sistemi i ngrohjes dhe pajiset janë të vendosura në mënyrë të tillë që të kryejnë detyra të ndryshme në kohë të ndryshme. Pajisjet mbledhin ajrin e ndotur nga zonat e gjimnastikës, kuzhina, administrata, korridoret etj.

b) Ventilatorët vendosen në tualete, në dhomat ku ka pajisje elektronike etj. Pajisjet duhet të shoqërohen me absorbues zhurme dhe kontrollues për volumin e ventilimit.

c) Ventilimi i zyrave qendrore duhet të bëhet duke pasur parasysh instalimet për çdo lloj moti.

85. Teknologjia MSR

a) Për operimin e pajisjeve të kësaj ndërtese duhet të mbahet parasysh:

i) inxhinieria e ngrohjes;

ii) teknologjia e ventilimit;

iii) teknologjia e ftohtë, teknologjia sanitare.

b) Sipas teknologjisë MSR janë të supervizuara në mënyrë ventrale, të rregulluara dhe të optimizuara. Një kontroll pajisjesh i decentralizuar duhet të përmbushë këto detyra: furnizimi i pajisjeve teknologjike të objektit dhe pajisjet e dispozimit duhet të dizenjohen në mënyrë të sigurt dhe ekonomike, duke mbajtur parasysh parametrat e paraqitur në shtojcën 6.

86. Kontrolli i zonës së lëvizjes

Zonat e shesheve të ajrimit, zonat e punës dhe të sportit duhet të mbikëqyren me videokamera (me *zoom pan* ose *remains*). Këto kamera fiksohen me lëvizje kontrolli të shpejta që mund të dallojnë distancën nga oficeri ose roja i kontrollit.

89. Zona e lëvizjes së makinave

Në zonën e lëvizjes së makinave instalohet kamera të lëvizshme që të mbikëqyret pjesa e poshtme e makinave.

90. Zona e brendshme

a) Para zonës së lëvizjes, në zonën e interrogimit bëhet supervizimi me kamera, të cilat janë të pajisura me sensorë lëvizjeje. Nëpërmjet kësaj është e mundur të shikohet zona në oraret normale të operimit dhe nga ana tjetër të shikohen edhe rojet, të cilët kryejnë inspektime gjatë natës në mënyrë që të bëhet e mundur të merren masa mbrojtëse nëse është e nevojshme. Zakonisht, kjo pajisje është me ngjyra.

b) Pajisjet e videos ndërmjet të tjerave, në varësi nga zona e mbikëqyrjes janë të pajisura me zoom, pan, remains, si funksione për ruajtjen e fasadave.

c) Kamerat e fasadave duhet të jenë të pajisura me ndryshime në informacionin që jep pamja në mënyrë që të sinjalizohet lëvizja.

ç) Për sa i përket sistemit automatik të fijëzimit edhe ky sistem duhet të menaxhohet nga kamerat dhe monitorët. Mund të realizohen edhe veprime manuale me kamera që kontrollohen nga qendra e kontrollit. Të gjitha kamerat do të kryejnë regjistrime në formë digjitale.

91. Dhoma e serverëve

a) Është dhoma ku do të qëndrojnë pajisjet kryesore të menaxhimit të të gjitha sistemeve të sigurisë e të IT-së të institucionit.

b) Për arsye sigurie dhoma e serverëve duhet të ndërtohet në ambientet e godinës së administratës civile. Është e rëndësishme që kjo dhomë të ndodhet jashtë regjimit të brendshëm dhe të jetë e paaksesueshme nga të dënuarit në rast të ndonjë revolte të mundshme.

c) Standardet e ndërtimit të dhomës së serverëve janë të përcaktuar me rregullore nga AKSHI.

92. Rrjeti kompjuterik

a) Është rrjeti, i cili do të përdoret nga telefonia e brendshme IP, sistemi i kamerave IP, kompjuterëve dhe printerëve të rrjetit.

b) Kabllot dhe fibra optike, të përdorura për ndërtimin e rrjetit, duhet të jenë të standardeve europiane. Për ndërtimin e rrjetit duhet të ndiqet standardi i shtresave të rrjetit (*acces layer, distribution layer, core layer*).

c) Pajisjet lidhëse të rrjetit (*switch* dhe *router*) duhet të kenë specifikat sipas shtresës së rrjetit ku ato do të përdoren. Pas përfundimit të rrjetit është e rëndësishme që të bëhet numeracioni i rrjetit, si dhe të

dorëzohet dhe një dokumentim i hollësishëm për pjesën fizike të rrjetit, si dhe pjesën logjike (konfigurimi i pajisjeve të rrjetit).

ç) Sasia dhe shpërndarja e rrjetit kompjuterik në zyra do të bëhet sipas numrit të punonjësve. Çdo punonjës në zyrë duhet të ketë postin e tij të punës, i cili është i pajisur me kompjuter, UPS, printer laser personal, akses në rrjetin kompjuterik dhe rrjetin elektrik për furnizimin e këtyre pajisjeve.

d) Materialet që do të përdoren për ndërtimin e rrjetit do të jenë kabllo *Ethernet Cat 5e*, fibër optike *patch panel, patch cord, patch* guidë, *rack* për rrjetin etj., ku sistemimi i tyre në pjesën e *rack*-ut është i rëndësishëm.

dh) Të gjitha kabllot e furnizimit me energji të jenë kundër zjarrit.

93. Serverët

a) Dhoma e serverëve duhet të pajiset me:

i) 3 copë serverë *rackmount 2 U brand name* ndërkombëtar;

ii) 1 copë *rack* 42 U +6 *cooller + Powerbar;*

iii) c) 1 copë KVM *switch rackmount* 6 porta me tastie, mouse e monitor 19' të integruar;

iv) ç) Sistem UPS me autonomi 4 orë për pajisjet e dhomës së serverëve, përfshirë dhe pajisjet e tjera që do të instalohen në këtë dhomë.

b) Serverët do të përdoren për ngritjen e një *domain controller*, sistemit të kartelave të të dënuarve dhe sistemin antivirus. Serverët KVM *switch* dhe *rack* duhet të jenë IT e njëjtit *brand name* ndërkombëtar.

c) Kapacitetet dhe specifikimet teknike të serverëve duhet të jenë jo më të vjetra se një vit nga data e instalimit dhe e vënies në eficencë e këtyre pajisjeve. Garancia për serverët duhet të jetë 3 vjet.

94. Kompjuterët

a) Shpërndarja e kompjuterëve duhet të jenë në sasi sipas numrit të punonjësve të administratës civile e policore të akomoduar në zyra në godinën e administratës.

b) Kompjuterët duhet të jenë *brand name* ndërkombëtarë dhe secili prej tyre të jetë i shoqëruar me UPS. Kapacitetet dhe specifikimet teknike të kompjuterëve duhet të jenë jo më të vjetra se një vit nga data e instalimit dhe e vënies në eficencë e këtyre pajisjeve.

c) Garancia për kompjuterët duhet të jetë 2 vjet.

95. Printerë personalë dhe printerë rrjeti

a) Çdo kompjuter duhet të jetë i shoqëruar me nga një printer personal laser ose për çdo 3 kompjuterë të ketë një printer rrjeti. Sasia e printerëve është në varësi të numrit të punonjësve të administratës të akomoduar në zyra.

b) Kapacitetet dhe specifikimet teknike të printerëve duhet të jenë jo më të vjetra se një vit nga data e instalimit dhe e vënies në eficencë e këtyre pajisjeve. Garancia për kompjuterët duhet të jetë 1 vit.

96. Fotokopje

a) Çdo institucion duhet të pajiset me të paktën 3 fotokopje:

i) 1 copë fotokopje laser bardhë e zi me kapacitete të mëdha fotokopjimi (50 faqe në minutë) dhe me garanci 3 vjet ose 600,000 kopje.

ii) 2 copë fotokopje laser bardhë e zi multifunksionale me kapacitete mesatare fotokopjimi (26 faqe në minutë) dhe me garanci 1 vit ose 120,000 kopje.

b) Kapacitetet e detajuara dhe specifikimet teknike të fotokopjeve duhet të jenë jo më të vjetra se një vit nga data e instalimit dhe e vënies në eficencë të këtyre pajisjeve.

KREU VII
SISTEMET E SIGURISË DHE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

97. Sistemi i kamerave

a) Të gjitha kamerat të jenë me I.P. minimumi 2 Mp, kamera, antivandal, WDR të standardit për burgje.

b) Kamerat e jashtme të rrotullueshme duhet të kontrollojnë gjithë territorin e burgjeve, të jenë I.P. kamera, antivandal, dite nate, WDR, min 2 Mp, të punojnë në kushtet ekstreme të mjedisit.

c) Kamerat duhet të mbulojnë të gjithë ambientin e jashtëm, të brendshëm, ku kryhen aktivitete gjatë gjithë veprimtarisë në burg.

ç) Në çdo ambient që ka veprimtari, përgjegjësi duhet të monitorojë me kamera ambientin e vet.

d) Softi i regjistrimit të jetë i sigurisë së lartë me certifikatë për mospërpunim figure.

dh) Koha e regjistrimit duhet të jetë minimumi 3 muaj.

e) Salla e monitorimit duhet të ketë minimumi 8 monitorë 52" të instaluar në një tavolinë ergonomike sipas ambientit dhe jashtë regjimit të burgut.

ë) Sistemi duhet të ketë pavarësi nga rrjeti për të paktën 12 orë.

f) Të gjitha instalimet duhet të jenë konform standardeve me emërtim të veçantë dhe të gjitha pajisjet e regjistrimit duhet të jenë në një *rack*.

g) Dhoma e serverëve duhet të jetë konform standardeve të AKSH-së.

gj) Sistemi nuk duhet të jetë më i vjetër se një vit nga data e implementimit të projektit.

h) Sistemi duhet të ketë matricë që operatori të ketë lehtësi në monitorimin e sistemit.

98. Sistemi i telefonisë

a) Telefonia e brendshme duhet të jetë I.P.

b) Telefona me I.P. duhet të kenë të gjitha ambientet ku kryhet veprimtari dhe ka person përgjegjës.

c) Të jetë për minimum 200 numra.

ç) Për ambientet e jashtme, si vendrojë duhet të koordinojë me sistemin trank të radiove digjitale që kanë buton paniku, 3-4 biseda në të njëjtën kohë etj.

d) Sistemi i telefonisë I.P., të integrohet me sistemet ekzistuese të burgjeve, rrjetin kompjuterik dhe atë të kamerave.

dh) Protokollet e tyre të jenë të njëjta me sistemet aktuale, pra sistemi që kemi vetëm zgjerohet.

99. Sistemi i bllokimi të valëve celulare

a) Instalimi i aparaturave dhe pajisjeve për bllokimin e të gjitha komunikimeve telefonike nëpërmjet çfarëdolloj aparati celular dhe satelitor, kudo që mund të ndodhen në territorin e burgjeve (brenda regjimeve të banimit të të dënuarve), duke përfshirë ndërtesat, barakat dhe të gjitha sipërfaqet e tjera specifike të shërbimeve, për të mos lejuar rrjedhjen e informacioneve të rëndësishme nëpërmjet këtyre komunikimeve nga ana e të dënuarve dhe personave të tjerë.

100. Kritere të përgjithshme

a) Modelet e aparaturave dhe i pajisjeve bllokuese të jenë prodhime të firmave të njohura të standardeve për aplikime në burgje. Aparaturat dhe pajisjet të jenë të cilësisë së lartë dhe të përshtatshme për të punuar në ambientet jashtë në kushte ekstreme të ambientit.

b) Numri, modelet dhe vendi i instalimit të pajisjeve bllokuese të jenë të tilla, që të sigurojnë bllokimin e sigurt për të gjitha komunikimet telefonike nëpërmjet çdolloj aparati telefonik celular dhe satelitor në të gjithë territorin e burgjeve, përfshirë godinat e banimit, barakat dhe sipërfaqet e tjera specifike të shërbimeve.

c) Pajisjet bllokuese duhet të punojnë detyrimisht në mënyrë të pandërprerë. Për këtë ato duhet të jenë me ushqim 220 V AC dhe ushqim 12 ose 24 v DC. Ato duhet të jenë të pajisura me bateri të brendshme dhe aksesorët përkatës për të siguruar një vazhdimësi në punë për një interval kohor prej minimumi 6 orë, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike nga rrjeti i furnizimit të burgut.

ç) Pajisjet bllokuese nuk duhet të interferojnë ose të ndikojnë në punën e pajisjeve dhe aparaturave të sistemit të komunikimit RF, të sistemit të monitorimit me kamera dhe rrjetit të kompjuterëve.

d) Pajisjet bllokuese dhe antenat rrezatuese duhet të instalohen në vende që lejojnë kryerjen e funksionit optimal të tyre dhe të mos dëmtojnë me rrezatime RF personelin e shërbimeve, punonjësit dhe personat që kryejnë dënimin në burg.

dh) Pajisjet bllokuese nuk duhet të interferojnë ose të bllokojnë komunikimet telefonike celulare dhe RF në objektet shtetërore dhe banesat civile, të cilat mund të jenë pranë territorit të burgjeve.

e) Pajisjet bllokuese nuk duhet të interferojnë ose të ndikojnë në punën normale të aparaturave elektromjekësore të instaluara në burg.

Të sigurojë servisin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi për 5 vjet.

101. Sistemi i mbrojtjes perimetrike

Projekti duhet të ofrojë një sistem të sigurisë me shumë pengesa rreth perimetrit të burgut. Këtu do të përfshihen:

a) Sistem alarmi me sensor, i shtrirë në gardhin rrethues për të zbuluar ngjitjet-prekjen.

b) Sistem me sensor të shtrirë në tokë për lëvizjet sizmike për të zbuluar lëvizjet dhe kanalet nëntokësore.

c) Sistem i shokimit i vendosur mbi gardhin e murit rrethues.

ç) Sistemin me infra për lartësitë.

d) Sistemet me telat me gjemba në formë spirale që përdoren për burgje.

dh) Kamera fikse që do të instalohen së bashku mbi gardhin perimetrik DTR për Motion Zbulimi Video (VMD) për lëvizje të dyshimta afër ose përmes gardhit.

e) Kamera të rrotullueshme PTZ instaluar rreth perimetrit që të sigurojë konfirmimin dhe alarmet e gjeneruara nga sistemi.

ë) Qendra e kontrollit e monitorimit për kontroll të plotë për të gjitha sistemet e ndërthurura nëpërmjet softit të lartë të sigurisë.

f) Furnizim të pandërprerë me energji elektrike (UPS) për të garantuar sigurinë e vazhdueshme dhe mbulimin në rast të një dështimi të energjisë.

g) Teknologjia e sistemeve nuk duhet të jetë më e vjetër se 1 vit nga implementimi i tij.

102. Sistemi i komunikimit me radio

a) Të jetë një trank digjital multisite 4 kanalesh.

b) Të gjitha shërbimet të kenë radiostacionere dhe çdo punonjës radio dore me GPS.

c) Të implementohet me sistemin aktual që ka Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, pasi është projekt në vazhdimësi dhe i pandarë.

ç) Çdo radio dore duhet të ketë GPS të inkorporuar:

a) Me *Software* me Hartën Digjitale të Shqipërinë dhe për GPS dhe DATA

b) Me *Software* për *Multi Site Trunk Network;*

c) Me *Software FleetSync AVL & Dispatch Messaging Software*, (AVL – Automatic Veicle ocation);

d) Të implementohet me sistemin e telefonisë I.P. që nga telefoni I.P. kërkon në radio personin e duhur dhe njëkohësisht në hartë përcakton dhe vendndodhjen e personit.

103. Sistemi i fonisë

Duhet të jetë i pajisur me:

a) Të jetë me qendër në sallën operative;

b) Në ajrim dhe ambientet me shumë lëvizje të ketë një autoporlant;

c) Në ambientet e qelisë të ketë një autoporlant me kontroll volumi;

ç) Të jetë i menaxhueshëm me kompjuter nëpërmjet rrjetit lan;

d) Akses në sistem të kenë 3 juzera.

104. Antena televizive kolektive

Duhet të ketë:

a) sinjal televiziv satelitor dhe tokësor;

b) për çdo qeli duhet të ketë një prizë antivandale;

c) sinjal të plotë në të gjitha qelitë;

ç) minimumi 4 kanale satelitore *free* të programueshme;

d) sistemin e ushqimit të antenës televizive të jetë i përqendruar te salla operative.

105. Sistemi i komunikimit qeli-oficer kryesor

a) me sinjal, me zë dhe alarm;

b) qendra e çdo alarmi duhet të jetë te përgjegjësi kryesor, por dhe oficeri i sallës operative;

c) e gjithë biseda duhet të regjistrohet në një PC për minimumi 1 muaj;

ç) brenda këtij sistemi duhet të jetë inkorporuar dhe radio me disa kanale;

d) pajisja duhet të jetë antivandal.

106. Dispozita të fundit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të bëjë përmirësimin periodik të standardeve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të ndërmarrë një punë sistematike për të ngritur nivelin e kapaciteteve njerëzore, në përdorimin e sistemeve të reja, në përputhje me teknikat e reja të menaxhimit.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshëm e Burgjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË	MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT	MINISTRI I SHËNDETËSISË
Eduart Halimi	**Sokol Olldashi**	**Halim Kosova**

SHTOJCA 1

SPECIFIKIMI I NDARJES SË AMBIENTEVE DHE VLERËSIMI I HAPËSIRAVE PËR SECILIN PREJ TYRE

Emërtimi i funksionit	Num. i dhomave	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për dhomë	Hapësira neto për njësi funksionale
Paraburgimi burra - 80 persona					
Seksioni 1 (40 persona)					
Qelia për 1 person (lavaman+tualet+dush te tualeti)	x	1P	9.0 m^2	9*x m^2	
Qelia për 2 persona (lavaman+tualet+dush te tualeti)	x	2P	14.0 m^2	14*x m^2	
Qelia për 4 persona (lavaman+tualet+dush te	x	4P	30.0 m^2	30*x m^2	

tualeti)					
Banjat e përbashkëta me dush (dhe tualet)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Magazinë e vogël për seksionin	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Magazinë për rroba e palara (e ventiluar)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë e mbeturinave (e ventiluar)	1x		8.0 m^2	8.0 m^2	
Zona e punës (lavatriçe+tharëse) (e ventiluar)	1x		6.0 m^2	6.0 m^2	
Dhomë për sportet/dhomë e përbashkët	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Dhomë për kohën e lirë me kuzhinë të vogël (leisure time room w/small kitchen)	1x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet ndihmëse, ekzaminimi gjyqësor)	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Shuma e seksionit I (40 persona)				404.0 m^2	
Shuma seksioni I (40 persona) njësoj si seksioni I				404.0 m^2	
Qeli burgimi i sigurt	2x	1P		18.0 m^2	
Qeli burgimi i sigurt me pajisje speciale për persona agresivë	2x	1P		18.0 m^2	
Magazinë (për të burgosurit) me ftohje – lidhje elektronike	1x			40.0 m^2	
Zyrë seksioni I-II për 3 roje+kuzhinë e vogël ndenjje me tualet (m/f)	1x			25.0 m^2	
Nëntotali				**1101.0 m^2**	**1101.0 m^2**
Grupet e të dënuarve, qelitë për meshkuj – 20 persona					
Seksioni III (20 të burgosur)					
Qelia për 1 person (lavaman+tualet)	4 x	1P	9.0 m^2	36.0 m^2	
Qelia për 2 persona (lavaman+tualet)	4 x	2P	14.0 m^2	56.0 m^2	
Qelia për 4 persona (lavaman+tualet)	2 x	4P	30.0 m^2	60.0 m^2	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1 x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Magazinë për lavanterinë (e ajrosur)	1 x		3.0 m^2	3.0 m^2	
Magazinë e vogël për departamentin	1 x		5.0 m^2	5.0 m^2	
Dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	1 x		8.0 m^2	8.0 m^2	
Zonë pune (lavatriçet dhe tharëset, e ajrosur)	1 x		6.0 m^2	6.0 m^2	
Dhoma e sporteve/dhomë e përbashkët për kohën e lirë	1 x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Dhoma e kohës së lirë/kuzhinë ndenjeje/dhomë për larjen e pjatave	1 x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet sociale, ekzaminimi gjyqësor)	1 x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Shuma seksioni III (20 të burgosur)				264.0 m^2	
Zyrë sek. III për 2 roje+kuzhinë ndenjeje me tualet (m/f). Departamenti i doktorit	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Nëntotali				**279.0 m^2**	**279.0 m^2**
Seksioni i grave (i përdorshëm edhe për minorenët) - 3 të burgosur					
Qelia për 1 person (lavaman+tualet)	1x	1P	9.0 m^2	9.0 m^2	
Qelia për 2 persona (lavaman+tualet)	1x	2P	14.0 m^2	14.0 m^2	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Ambiente të tjera shtesë për gra	1x	1P	10.0 m^2	10.0 m^2	
Shuma, seksioni i grave (3 të burgosura)				43.0 m^2	
Shuma, seksioni i grave				**43 m^2**	**43.0 m^2**
Të mitur – 7 të burgosur					

Seksioni IV (7 të burgosur; infrastruktura edhe për gratë)					
Qeli për 1 person (lavaman+tualet)	1x	1P	9.0 m^2	9.0 m^2	
Qeli për 2 persona (lavaman+tualet)	1x	2P	14.0 m^2	14.0 m^2	
Qeli për 4 persona (lavaman+tualet)	1x	4P	30.0 m^2	30.0 m^2	
Dushe të përbashkëta (me tualet)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Magazinë për lavanterinë (e ajrosur)	1x		3.0 m^2	3.0 m^2	
Magazinë e vogël për departamentin	1x		5.0 m^2	5.0 m^2	
Dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	1x		6.0 m^2	6.0 m^2	
Zonë pune (lavatriçet dhe tharëset e ajrosur)	1x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Dhoma e sporteve/dhomë e përbashkët për kohën e lirë	1x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Dhoma e kohës së lirë/kuzhinë ndenjeje/dhomë për larjen e pjatave	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Magazinë për të burgosurit+lavaman (doktori, shërbimet sociale, ekzaminimi gjyqësor)	1x		15 m^2	15 m^2	
Ambiente të tjera shtesë për të mitur	1x	1P	10.0 m^2	10.0 m^2	
Shuma e seksioni IV (7 të burgosur)				182 m^2	
Zyrë seksioni IV për 2 roje+kuzhinë ndenjeje me tualet (m/f)	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Shuma e seksioneve				**197 m^2**	**197.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Hapësirë ndihmëse – Shërbimi mjekësor i Spitalit nr. 5, të burgosur					
Shërbimi i doktorit					
Zyrë për doktorin, psikiatrin, magazinë për ilaçet (me rafte), doktorët konsulentë	1x	1P	16.0 m^2	16.0 m^2	
Zyrë për dentistin + dhomë për grafitë e dhëmbëve	1x		16.0 m^2	16.0 m^2	
Dhomë mjekimi e infermiereve dhe pritjeje për të burgosurit (e ajrosur, me tualet, me dritare) meshkuj/femra	1x		16.0 m^2	16.0 m^2	
Dhomë për pacientët, secila me 2 krevate dhe me lavaman/burra (e përshtatshme edhe për handikapë)	2x	2P	14.0 m^2	28.0 m^2	
Dhomë për pacientët me 1 krevat me tualet/dush/ lavaman/minorenë/meshkuj	1x	1P	9.0 m^2	9.0m^2	
Vaskë me dush (e përshtatshme për persona handikapë)	1x		8.0 m^2	8.0 m^2	

Tualetet për të burgosurit (të ndara burrat nga gratë) dhe vaskë me dush (e përshtatshme për persona handikapë) në ambient të veçantë	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Dhomë gjumi e mjekut dhe dhomë gjumi e infermierit	2x	1P	32 m^2	32 m^2	
Magazinë dhe dhomë për mbeturinat (e ajrosur)	2x		15.0 m^2	15 m^2	
Qeli për shërbimet sociale (i burgosur i punësuar) burra/gra	1x	1P	10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë e promocionit dhe e psikologes	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Dhoma e terapisë intensive për riaftësim fizik	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Shuma, shërbimi i doktorit				**195.0 m^2**	**195.0 m^2**

Zyrë për shërbimet sociale në sektorin e administratës (2 persona)	1x	2P	15.0 m^2	15.0 m^2	
Shërbimi psikologjik (1 person)	1x		8.0 m^2	8.0 m^2	
Zyrë për testim dhe zyrë për hetim	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Zyre e shërbimeve sociale	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Shuma				**43.0 m^2**	**43.0 m^2**
Nëntotali, shërbimet sociale					**238.0 m^2**

Institucionet e përgjithshme për të burgosurit					
Holl për qëllime të ndryshme për të burgosurit (aktivitete, kishë) e ndashme në dhoma të veçanta (gardërobë/sskristi dhe tualet për aktorët)	1x	40P	90.0 m^2	90.0 m^2	
Librari me zyrë	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Shuma e institucioneve të përgjithshme				**130.0 m^2**	**130.0 m^2**

Dhoma e sporteve dhe gjimnastikës					
Emri i funksionit	Num. Dhoma ve	Persona për dhomë	Hapësira neto për dhomë	H n d	apësira neto për njësi unksionale
Dhoma qendrore e rojeve					
Zyrë për rojet, përgjegjësin dhe grupin e gatshëm, supervizioni qendror, pajisjet elektronike, rafti i çelësave dhe i armëve	1x		70 m2	7	
Dhoma për armët speciale dhe shefin e armatimeve	1x		16.0 m2	1	
Dhomë zhveshjeje për 35 roje me dush dhe tualet	1x		40.0 m2	4	
Dhomë e gatshme në afërsi të dhomës qendrore të gardianëve për 3 persona me kuzhinë ndenjeje dhe dhomë për pjatat	2x		15.0 m2	1	
Kuzhinë ndenjeje për gatishmërinë	1x 1x		10.0 150.0 m^2	1	150.0 m^2
Dhomë pushimi për shërbimin e natës	2x		15.0 m2	1	

Dhomë për mbrojtjen nga zjarri					
Shuma e dhomës qendrore të rojeve					
Holli i gjimnastikës (aktivitete të ndryshme)					
Shuma e dhomës së gjimnastikës				**150.0 m²**	**150.0 m²**

Zona e ekzaminimit të vizitorëve					
Zona e hyrjes					
Vendhyrja për vizitorët me pajisje elektronike, rafte të vogla me mbyllje dhe gardërobë me rreze (si në aeroporte)	1x		25.0 m²	25.0 m²	
Dhoma e depozitimit të bagazheve (transit për në hapësirat e mbyllura)	1x		15.0 m²	15.0 m²	
Zyra për rojën e derës dhe të regjistrimit të vizitorëve, hapësirë për një rojë dhe armët dhe celularët e policëve dhe avokatëve	1x		15.0 m²	15.0 m²	
Dhomë për kontrollin e vizitorëve	1x		5.0 m²	5.0 m²	
Shuma e zonës së ekzaminimit të vizitorëve				**60.0 m²**	**60.0 m²**

Vendhyrja e komandueshme nga roja i derës, më pas zona e hyrjes së mëtejshme					
a) Në zonën e hyrjes së të burgosurve (opsionale) e përdorshme edhe për autobusë					
b) Në zonën e kapanoneve të punës dhe transporti (ashensori!) (opsionale) e përdorshme për kamionë të mëdhenj					

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Zona e vizitorëve dhe e marrjes në pyetje					
Dhomë pritjeje për vizitorët me tualete (burra/gra, e përshtatshme për handikapë) 1 vend për fëmijë	1x		25.0 m²	25.0 m²	
Salla për shërbime sociale, shërbimet e lirimit me kusht, direkt afër zyrës së rojeve	1x		15.0 m²	15.0 m²	
a) Dhomë për vizitorët me ndarje strikte ndërmjet vizitorëve dhe të burgosurve më 8 vende takimi (secili për 4 vizitorë)	1x		40.0 m²	40.0 m²	
b) Dhomë e vizitorëve për vizitat në tavolinë	1x		20.0 m²	20.0 m²	
Dhomë për ekzaminim gjyqësor, konferenca vizita në tavolinë (avokatë, zyrtarë të tjerë)	2x		15.0 m²	30.0 m²	
Zyrë për shikimin e vizitorëve dhe koordinimin, e pajisur me citofon dhe supervizim me videokamera (1 gardian)	1x		15.0 m²	15.0 m²	
4 dhoma pritjeje për të burgosurit, secila për 10 persona me tualet (e ajrosur, me dritare)	2x	10P	15.0 m²	30.0 m²	
Zonë pritjeje për vizitorët me hapësirë për fëmijët	1x		30.0 m²	30.0 m²	

Shuma e zonës së vizitorëve dhe e marrjes në pyetje				**205.0 m²**	**205.0 m²**

(Opsionale) Zona e marrjes në pyetje e vendosur në ballë të paraburgimit – prokuror, gjykatës					
Zona e interrogimit polici/prokuror e gjykatës	2x		15.0 m²	30.0 m²	
Zona e interrogimit për avokatët	2x		15.0 m²	30.0 m²	
Dhomë për masën e gjykimit (për paraburgimin/minorenët)	1x		20.0 m²	20.0 m²	
Dhomë pritjeje për të burgosurit, për 10 persona me tualet	1x		25.0 m²	25.0 m²	
Shuma e zonës së interrogimit për paraburgimin/gjykata					**105.0 m²**

Shkolla (të rinjtë)					
Klasat	1x	7P	30.0 m²	30.0 m²	
Dhoma e pajisjeve të mësuesve	1x		10.0 m²	10.0 m²	
Tualetet/lavamanët/të burgosur m/f				10.0 m²	
Tualetet/lavamanët/të punonjësit m/f				10.0 m²	
Salla me mundësi për ngrënie	1x	7P	20.0 m²	20.0 m²	
Dhomë për pjatat mbeturinat etj.	2x		10.0 m²	10.0 m²	
Magazinë, pajisjet e pastrimit, mbeturinat	1x		10.0 m²	10.0 m²	
Shuma e shkollës				**110.0 m²**	**110.0 m²**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Dhomat e punës: Arte, ergoterapike, dhomat e punës motivuese					
Ergoterapia	1x	5P	25.0 m²	25.0 m²	
Dhomat e punës motivuese	1x	5P	20.0 m²	20.0 m²	
Dhomë sociale	1x		20.0 m²	20.0 m²	
Magazinë për punët e kryera	1x		10.0 m²	10.0 m²	
Zyrë për 1 person	1x		10.0 m²	10.0 m²	
Shuma e dhomave të punës				**85.0 m²**	**85.0 m²**

Zyra (drejtoria, komanda, administratë e ekzekutimit penal, ekonomistja)					
Drejtoria					
Zyrë e drejtorisë për mbledhje me 6 vende	1x		25.0 m²	25.0 m²	
Zyrë për mbledhje me kuzhinë të vogël për 25 persona	1x		50.0 m²	50.0 m²	
Zyrë e përfaqësuesve të drejtorisë me mundësi mbledhjeje për 4 persona	1x		20.0 m²	40.0 m²	

Zyrë për 2 persona	2x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Dhoma e teknikut të kompjuterëve pranë dhomës së trajnimit për kompjuter	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Magazinë për dokumente	1x		20.0 m^2	25.0 m^2	
Zyrë për 1 person	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Shuma e drejtorisë				**180.0 m^2**	**180.0 m^2**

Komanda e rojeve					
Zyra e përgjegjësit të rojeve për mbledhje me 4 persona	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Zyra e përfaqësuesit të përgjegjësit të rojeve (1 person) për mbledhje për 3 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Zyra e punonjësve për 3 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Zyra e punonjësve për 3 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Shuma e komandës së rojës				**65.0 m^2**	**65.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Administrata e ekzekutimit penal					
Zyrë pritjeje (3 persona)	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Zyra e administratës së ekzekutimit penal (3 persona)	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Dhomë pritjeje për të burgosurit (pranim/lirim), secila për 2 persona	2x	2P	5.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë kontrolli për të burgosurit me dush dezinfektimi dhe tualet	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë për kontroll trupor për të burgosurit, për 2 persona	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Zyrë për edukim dhe kohën e lirë për mbledhje për 2 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Zyrë për çështje të tjera për 2 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Shuma – administrata e ekzekutimit penal				**100.0 m^2**	**100.0 m^2**
Administrata ekonomike					
Zyrë për çështje pune për 2 persona	2x		20.0 m^2	20.0 m^2	
1 dhomë e madhe për çështje financiare për 2 persona	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Zyrë për administratën	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Zyrë për financën	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
				65.0 m^2	**65.0 m^2**

Shuma – administrata ekonomike					
Magazinë, garazh					
Magazinë tekstilesh	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Magazinë për uniforma	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Magazinë për tekstile private për të paktën 115 të burgosur me vend për sende me vlerë dhe vend për 1 person	1x		50.0 m^2	50.0 m^2	
Garazh,1 makinë	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Zyrë me lavaman (1 gardian)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë për gomat rezervë dhe pjesët e këmbimit të makinave	1x		10.0 m^2	15.0 m^2	
Magazinë e përgjithshme E1	1x		100.0 m^2	100.0 m^2	
Dhome për servise elektro-mekanik	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Shuma, magazinë, garazh				**295.0 m^2**	**295.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Kuzhina					
Dhomë për mbeturinat (me/pa ventilim)	2x		10.0 m^2	20.0 m^2	
Hapësira për kuzhinë për 115 të burgosur + 50 gardianë	1x		100.0 m^2	100.0 m^2	
Zyrë për llogaritjen e ushqimit, administrimi i kuzhinës dhe marrja e materialeve duke përfshirë tualetet, lavamanët, dhomën e zhveshjes – m/f	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Hapësirë për parkim dhe pastrimin e mjeteve të shpërndarjes së ushqimit			20.0 m^2	20.0 m^2	
Dhomë sociale dhe për ngrënie për të burgosurit që punojnë në kuzhinë	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Magazina e kuzhinës	1x		60.0 m^2	60.0 m^2	
Dhomë me ftohje (magazinim i veçantë për ushqimet)	1x		20.0 m^2	60.0 m^2	
Dhoma me ftohje	1x		10.0 m^2	20.0 m^2	
Parafrigoriferimi	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Shuma, kuzhina				**330.0 m^2**	**330.0 m^2**
Lavanteria					
Lavanteria – dhoma e lavatriçeve	1x		80.0 m^2	80.0 m^2	
Dhoma e materialeve për t'u larë	1x		30.0 m^2	30.0 m^2	
Dhoma e materialeve të pastra (që janë larë)	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Magazinë për pajisjet	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	

Dhomë sociale për të burgosurit (tualet dhe dush)	1x	7P	20.0 m^2	20.0 m^2	
Zyrë për një person (tualet/lavaman)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Shuma, lavanteria				**195.0 m^2**	**195.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Furra e bukës					
Dhomë pune	1x		80.0 m^2	80.0 m^2	
Dhomë me ftohje të shpejtë	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Magazinë buke (për daljet)	1x		25.0 m^2	25.0 m^2	
Zyrë për një person (tualet/lavaman)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë sociale me tualet/dush për 10 të burgosurit	1x	10P	15.0 m^2	15.0 m^2	
Magazina e materialeve për prodhim	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Shuma, furra e bukë				**170.0 m^2**	**170.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Hapësirë e përgjithshme pune e lidhur me kapanonet e punës					
Kapanonet e punës (përpunim metali, instalime elektrike, punë nga kompanitë private, ndarja e mbeturinave, (opsionale) për 30 të burgosur me magazinat e nevojshme; 1 dhome të madhe, e ndarë në hapësira të tjera)	1x	30P	300.0 m^2	300.0 m^2	
Magazinë	2x		20.0 m^2	40.0 m^2	
Zyrë për kapanone të ndryshme pune (kontroll) (1 gardian)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Zyrë për kopshtarin (1 gardian)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhomë për menaxherin e çelësave (të kapanoneve të punës dhe magazinave) (1 gardian)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Tualet për punonjësit (meshkuj/femra)	1x		15.0 m^2	15.0 m^2	
Dhomë zhveshjeje, dush dhe tualet për të burgosurit	1x		35.0 m^2	35.0 m^2	
Dhomë ndenjeje për ditën për të burgosurit (+ kopshtari)	1x	30P	10.0 m^2	10.0 m^2	
Dhoma e mbeturinave	1x		8.0 m^2	8.0 m^2	
Zyrë për çështje të tjera për 2 persona			10.0 m^2	10.0 m^2	
Shuma, kapanonet e punës të lidhura				**448.0 m^2**	**448.0 m^2**

Institucione të përgjithshme					
Magazinë për dosjet	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Ambiente ndihmese për personelin e lartë	1x		20.0 m^2	20.0 m^2	
Dhomë për pjatat për 50 punonjës	1x	50P	80.0 m^2	80.0 m^2	

Vende për lavash + garazh për makinat zyrtare	1x		18.0 m^2	18.0 m^2	
Apartamenti i drejtorit	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Shuma, institucione të përgjithshme				**198.0 m^2**	**198.0 m^2**

Zonat për materialet dhe mbeturinat					
Mundësi për hyrje, paraoborr (të paktën (10m x15m BxL)	1x		10.0 m^2	10.0 m^2	
Ndarje (minimumi 10m x 20m/BxL) 2 Lanes	1x			75.0 m^2	
Zona e marrjes së mallit (e arritshme nga të gjitha departamentet) zona e shkarkimit për firmat që sjellin mall me lidhje për te ashensori i transportit për në kapanonet e punës etj. (opsionale) vend për kthesë për autobusin e të burgosurve 20m (ca 30m x 30 m)				900.0 m^2	
Dhoma e mirëmbajtjes	1x		40.0 m^2	40.0 m^2	
Dhoma e mbeturinave A+B me mundësi për zhvendosje (1x pajisje ftohëse)	2x		25.0 m^2	50.0 m^2	
Shuma e zonës për materialet dhe mbeturinat				**1075.0 m^2**	**1075.0 m^2**

Emri i funksionit	**Num. i dhomave**	**Persona për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për dhomë**	**Hapësira neto për njësi funksionale**
Zonat e jashtme për shëtitje/zonat e lira					
3. Zonat e jashtme për shëtitje, kontrolli i përgjithshëm, një për gratë dhe minorenët e arritshme direkt nga departamentet					
Zona e jashtme për shëtitje - paraburgim	1x	30P	250.0 m^2	250.0 m^2	
Zona e jashtme për shëtitje - jetesa në grup	1x	10P	100.0 m^2	100.0 m^2	
Zona e jashtme për shëtitje - minorenët	1x	7P	100.0 m^2	100.0 m^2	
Zona e jashtme për shëtitje - departamenti i spitalit	1x	5P	50.0 m^2	50.0 m^2	
Zona e jashtme për shëtitje - gratë	1x	3P	40.0 m^2	40.0 m^2	
Kopsht me market	1x		100.0 m^2	100.0 m^2	
Zona e jashtme për vizitorët	1x		50.0 m^2	50.0 m^2	
Shuma e zonës së jashtme për shëtitje/zonat e lira				**690.0 m^2**	**690.0 m^2**
Vend për parkim makinash					
Vend për parkim për punonjësit	50x				
Vend për parkim për vizitorët	30x				
Shuma, vende për parkim makinash	**80x**				

Emri i funksionit	**Njësia**
Seksioni i burrave	1101 m^2
Seksioni i burrave, dhoma për ndenje në grup	279 m^2
Seksioni i grave, dhoma për ndenje në grup	43 m^2
Seksioni i të miturve	197 m^2
Seksioni i spitalit	238 m^2
Institucionet e përbashkëta (fetare, edukimit etj.)	130 m^2
Palestra e gjimnastikës dhe e sporteve	150 m^2
Dhoma qendrore e gardianëve	211 m^2

Dhoma hyrëse për kontrollin e vizitorëve.	60 m^2
Salla e qëndrimit të vizitorëve dhe e informacionit	205 m^2
Zona e dhomave të marrjes në pyetje të të dënuarve	105 m^2
Ambiente të shkollimit profesional të të miturve.	195 m^2
Zyra të administratës	180 m^2
Zyra qendrore e gardianëve	65 m^2
Blloku i dhomave të ekzekutimeve penale	100 m^2
Blloku i zyrave ekonomike dhe e administratës.	65 m^2
Magazine, garazhe	295 m^2
Kuzhina	330 m^2
Lavanteria	195 m^2
Furrat e pjekjes së bukës	170 m^2
Ambiente pune të përgjithshme	448 m^2
Blloku i zyrave të institucioneve të rëndësishme	198 m^2
Zona e furnizimeve të ndryshme dhe e heqjes së mbeturinave	1075 m^2
Nëntotali i sipërfaqes së regjimit të brendshëm	6035 m^2
Sipërfaqe e lirë brenda regjimit të brendshëm	690 m^2
Sipërfaqja totale e regjimit të brendshëm	6725 m^2
Vende parkimi	80

Totali i zonave të mbajtjes nën mbikëqyrje të të burgosurve	
Zona e meshkujve - paraburgim	80
Zona e meshkujve që vuajnë dënimin në qeli të përbashkët	20
Zona e femrave	3
Zona e të miturve	7
Zona e spitalit	5
Kapaciteti total	**115**

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I HAPËSIRËS

Emri i hapësirës	Njësia	Sasia
Hapësira nga programi funksional	m^2	**6035**
50% shtesë për infrastrukturë të përgjithshme (lëvizje)	m^2	**3362**
Nëntotali	m^2	**9397**
5% shtesë për zonën e murit	m^2	**470**
Totali për zonën e planifikuar	m^2	**9867**
10 % zonë e lëvizjes së brendshme/zona të lira	m^2	**986**
Totali i regjimit të brendshëm	**m^2**	**10853**

SHTOJCA 2
PËR PAJISJEN E AMBIENTEVE, STANDARDEVE DHE MJETEVE TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR

	Objektet/sendet	Sasia
Dhomë e vizitave të mjekut, S=16m²	Krevat vizitash mjekësore	copë 1
	Tavolinë pune	copë 1

	Karrige	copë 2
	Kompjuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Dollap për mbajtje dokumentacioni	copë 1
Dhomë gjumi e mjekut me S=16m²	Krevat fjetjeje	copë 1
	Tavolinë	copë 1
	Karrige	copë 1
	Kompjuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Frigorifer	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Aneksi i dhomës (tualeti) me S= 4 m²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë mjekimi e infermierëve me S=16 m²	Krevat vizitash mjekësore	copë 2
	Tavolinë mjekimi	copë 1
	Tavolinë pune	copë 1
	Karrige	copë 2
	Dollap për mbajtje urgjence	copë 1
Dhomë gjumi e infermierëve me S=16 m²	Krevat fjetje	copë 1
	Tavolinë	copë 1
	Karrige	copë 2
	Kompjuter	copë 1
	Televizor,	copë 1
	Frigorifer	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Aneksi i dhomës (tualeti) me S=4 m²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë farmacie me S= 16 m²	Të gjitha pajisjet që duhen për funksionimin e një farmacie	
Aneksi i farmacisë (tualeti) me S=4 m²	Lavaman	copë 1
	Banjë	copë 1
	Bide	copë 1
	Dush	copë 1
	Kosh plehrash	copë 1
Dhomë e Promocionit dhe Psikologes me S=16 m²	Tavolinë pune	copë 1
	Karrige	copë 6
	Kompjuter	copë 1
	Televizor	copë 1
	Rafte librash	copë 1
	Dollap gardërobë	copë 1
Dhomë e aparaturave mjekësore me S= 24 m²	Aparat Rongeni (Scopi dhe Grafi) Echo Abdominale	
Dhomat e shtrimeve ditore me S= 16 m² (për dy persona)	Krevat fjetje	copë 2
	Tavolinë	copë
	Karrige	copë 2

SHTOJCA 3
VLERAT E IDENTIFIKIMIT FIZIK

Komponentët	**Tipi**	**Mbrojtja e ngrohjes**	**Mbrojtja e zhurmës së ajrit**	**Mbrojtja e zhurmës së goditjes**
		U [Ë/m2 K]	Rë or Dn /të [dB]	Ln/të [dB]
Muret e jashtme	AË	<<hp1 5 = 0>__ 0.50</hp1 5=0>	≥47	-
Muret e jashtme në tokë	AË	<<hp1 5 = 0>__ 0.50</hp1 5=0>	-	-
Çatia e rrafshët	AË	<<hp1 5 = 0>__ 0.20</hp1 5=0>	≥47	-
Kalimet	FD	<<hp1 5 = 0>__ 0.20</hp1 5=0>	≥47	<<hp1 5 = 0>__ 48</hp1 5=0>
Dyshemetë që prekin tokën	DU	<<hp1 5 = 0>__ 0.20</hp1 5=0>		<<hp1 5 = 0>__ 48</hp1 5=0>
Kat kundër mosngrohjes	GD	<<hp1 5 = 0>__ 0.40</hp1 5=0>		<<hp1 5 = 0>__ 48</hp1 5=0>
Ndarjet e kateve	GD	<<hp1 5 = 0>__ 0.90</hp1 5=0>	≥55	<<hp1 5 = 0>__ 48</hp1 5=0>
Muret e brendshme kundrejt dhomave të pangrohura	ËU	<<hp1 5 = 0>__ 0.70</hp1 5=0>	≥55 or (≥44)	-
Muret e brendshme	IË	<<hp1 5 = 0>__ 1.60</hp1 5=0>	≥55 or (≥44)	
Dyert/dritaret	F	<<hp1 5 = 0>__ 1.90</hp1 5=0>	-	-
Dyert e jashtme	T	<<hp1 5 = 0>__ 1.70</hp1 5=0>	-	-

SHTOJCA 4
VLERAT E NDRIÇIMIT SIPAS AMBIENTEVE

Garazhet	100 lux

Ambienti i pajisjeve teknologjike	100 lux
Pajisjet teknologjike zona e shpërndarjes	200 lux
Magazinë për sende të forta	100 lux
Magazinë	200 lux
Korridoret shkallët	200 lux
Zyrat	500 lux
Qelitë e burgimit	200 lux
Zonat e lëvizjes	50 lux
Zona ekonomike	50 lux
Zona sportive	30 lux
Zona e paraalarmit dhe alarmit	100 lux

SHTOJCA 5
NORMAT E TEMPERATURAVE

Interpretimi i temperaturës	
Nëndyshemeja ngrohje sekondare	45°C/ 35°C
Uji i ngrohtë	65°C/35°C
Ngrohja e sipërfaqeve statike	65°C /45°C
Ngrohje në regjistrim ventilim	65°C/35°C
Pllakat spot	65°C/55°C

SHTOJCA 6
PARAMETRAT E TEKNOLOGJISË MSR SIPAS AMBIENTEVE

Emri i hapësirës	Temperatura e dhomës në gradë Celcius	Ventilimi mekanik LË/H	Prurja e ajrit dhe e ajrit të ndotur
Gardëroba	24	4	
Dhoma e doktorit	24	-	-
Zyrat	20	-	-
Dhomë ndenjeje, sporti, ompjuteri	20	-	-
Dhomë larjeje	20	6	
Lavanteria	20	4	
Dhomë trajnimi	20	2	
Magazinë	18	1	
Bodrum	15	1	
Tualet	18	4	-
Dushet	24	6	-
Dhoma e fesë multifunksionale	20	3	
Zona e gjimnastikës	20	2	
Dhoma e mbeturinave	E pangrohur	20	Vetëm ajër të ndotur
Dhoma e mbetjeve	15	4	-
Dhoma e kompjuterit	E pangrohur	Sipas standardeve	Vetëm ajër të ndotur
Zyrë	20	1	
Dhoma e hetimit	20	2LË	
Dhoma e pritjes e vizitorëve	20	1	
Ekzaminimi	20	1	
Dhomë sociale	20	2	
Kapanon pune	18	Makineri/siphoning	-
Dhomë kontrolli personal	22	2	
Kuzhina	20	Sipas standardeve	
Zona e magazinimit të ftohtë	-	Zonë ftohëse	-
Mensa	20	4	
Hyrja e godinës	20	1	
Dhomë e përbashkët	20	2	
Dhoma e aktiviteteve sociale	15	-	-

Në dhoma	-	Ventilim mekanik	-

SHTOJCA 5

REFERENCA LIGJORE DHE TË TJERA, QË DUHET PASUR PARASYSH GJATË HARTIMIT TË PROJEKTPREVENTIVIT PËR NDËRTIMIN OSE RIKONSTRUKSIONIN E BURGJEVE

Për caktimin e kritereve të standardizuara në ndërtimin dhe rikonstruksionin me cilësi të burgjeve dhe paraburgimeve duhet t'u referohemi, ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve te miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave të fushës së ndërtimeve në Republikën e Shqipërisë, si dhe atyre të BE-së. Më kryesorët prej tyre janë:

- Vendimi nr. 68, datë 15.2.2001, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 3.5.2002, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 10.1.2003, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 19.6.2004 "Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit".

- Ligji nr. 9290, datë 7.10.2004, i ndryshuar me ligjin nr. 9825, datë 1.11.2007 dhe ligjin nr. 10 327, datë 30.9.2010, "Për produktet e ndërtimit".

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 2.11.2000 "Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime", dhe ligji nr. 8402, datë 10.7.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 9200, datë 26.02.2004 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim"

- Ligjin nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin"

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 22.10.2004 "Për rregullat teknike për parandalimin e zjarreve në konstruksione, ndërtime me aktivitet akomodues turistik"

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara".

Në zbatim të vendimit nr. 68, datë 15.2.2001, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 3.5.2002, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 10.01.2003, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 19.6.2004 "Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit", arkitektët, inxhinierët dhe specialistët e ndërtimit, gjatë projektimit, ndërtimit dhe rikonstruksionit me cilësi të burgjeve dhe ambienteve të paraburgimit, duhet të zbatojnë me përpikëri dhe rigorozitet standardet dhe kushtet teknike të projektimit e zbatimit. Veçanërisht, përdorimit të standardeve që kanë të bëjnë me sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, sipas lidhjes nr. 1 dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në zbatim të ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004, për produktet e ndërtimit, i ndryshuar me ligjin nr. 9825, datë 1.11.2007 dhe ligjin nr. 10 327, datë 30.9.2010, projektuesit dhe ndërtuesit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e burgjeve dhe të paraburgimit, duhet:

Gjatë projektimit dhe ndërtimit me cilësi të lartë të këtyre objekteve, është e domosdoshme që të merren në konsideratë përdorimi i materialeve të ndërtimit, sipas standardeve të KTP-së dhe KTZ-së, që kanë shkallë të lartë sigurie, rezistence dhe qëndrueshmëria mekanike.

Në zbatim të vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 2.11.2000 "Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime", ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 699, datë 22.10.2004 "Për rregullat teknike për parandalimin e zjarreve në konstruksione, ndërtime me aktivitet akomodues turistik" projektuesit dhe ndërtuesit për ndërtimin dhe rikonstruksionin e burgjeve dhe të paraburgimit, duhet:

Të projektojnë sipas standardeve, ku të përfshihen: termoizolimi, ngrohja, siguria në raste zjarri, higjienë, mbrojtja nga zhurmat, ndërtimi i shkallëve të emergjencës për evakuimin e të burgosurve dhe personelit të shërbimit në raste tërmeti, zjarri etj. ndërtimi i rampave të pjerrëta dhe ashensorëve për të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara etj.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008 për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara", duhet:

Gjatë projektimit dhe ndërtimit të burgjeve dhe paraburgimit, detyrimisht duhet të aplikohen zgjidhje teknike dhe të eliminohen barriera penguese për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim që të sigurohet lëvizja e tyre pa pengesa dhe qëndrimi në këto ambiente të jetë i njëjtë me personat e tjerë.